



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISE DHE INOVACIONIT
INSPEKTORATI I PËRGJITHSHËM

Nr. 1883 Prot.

Tiranë, më 08.07.2026

URDHËR 248, Datë 08.07.2026.

**PËR MIRATIMIN E RREGULLOREVE “PËR HETIMIN ADMINISTRATIV
TË KËRKESËS SË SINJALIZUESIT PËR MBROJTJEN NGA VEPRIMET
HAKMARRËSE NË INSPEKTORATIN E PËRGJITHSHËM”**

DHE

**“PËR HETIMIN ADMINISTRATIV TË SINJALIZIMIT DHE MBROJTJEN E
KONFIDENCIALITETIT NË INSPEKTORATIN E PËRGJITHSHËM”**

Në mbështetje të ligjit nr.99, datë 12.09.2024 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 3 e nenit 14, të ligjit nr. 96/2025 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve" dhe VKM Nr. 330, datë 11.6.2025 “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Përgjithshëm”,

URDHËROJ:

Miratimin e rregulloreve “Për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga veprimet hakmarrëse në Inspektoratin e Përgjithshëm” dhe “Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Inspektoratin e Përgjithshëm”, sipas rregulloreve/teksteve që i bashkëlidhen këtij urdhri.

Ngarkohet Struktura Përgjegjëse e miratuar me Urdhrin nr. 248 datë 07.07.2026, për zbatimin e tyre.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

Dashnor Sula





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
INSPEKTORATI I PËRGJITHSHËM

RREGULLORE
PËR HETIMIN ADMINISTRATIV TË SINJALIZIMIT DHE MBROJTJEN E
KONFIDENCIALITETIT NË INSPEKTORATIN E PËRGJITHSHËM

Tiranë, Korrik 2026

KREU I RREGULLA TË PËRGJITHSHME

NENI 1 BAZA LIGJORE

Rregullorja për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Inspektoratin e Përgjithshëm, bazohet në Ligjin nr.96, datë 18.12.2025, *“Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”*, Kodin e Procedurave Administrative, si dhe në urdhrat, udhëzimet dhe aktet e tjera nënligjore të miratuara nga Inspektori i Përgjithshëm.

NENI 2 OBJEKTI

Objekti i Rregullores është:

- a) përcaktimi i rregullave për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit nga Inspektori i Përgjithshëm dhe përcaktimin e mekanizmave të mbrojtjes së konfidencialitetit në zbatim të Ligjit nr.96, datë 18.12.2025, *“Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”*;
- b) përcaktimi i rregullave kornizë për autoritetet publike dhe subjektet private në lidhje me përmbajtjen e rregullores së brendshme për procedurat e hetimit administrativ dhe masat për mbrojtjen e konfidencialitetit, të miratuara prej këtyre të fundit në zbatim të nenit 20, pika 8, të Ligjit nr. 96/2025 *“Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”*.

NENI 3 PARIMET E HETIMIT ADMINISTRATIV NGA ILDKPKI

Inspektori i Përgjithshëm për zbatimin e Ligjit nr. 96/2025 *“Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”*, bazohet në parimet dhe ushtron kompetencat:

- a. me ndershmëri, paanshmëri dhe efikasitet, duke pasur parasysh interesat legjitimë të sinjalizuesit;
- b. në mënyrë të pavarur nga pikëpamja politike dhe çdo influencë tjetër e padrejtë që mund të pengojë realizimin e detyrave;
- c. duke shmangur çdo konflikt interesi të mundshëm përpara fillimit të hetimit administrativ;
- d. duke marrë të gjitha masat e përshtatshme për të mbrojtur dokumentacionin dhe provat lidhur me sinjalizimin nga zhdukja, fshehja, ndryshimi, falsifikimi dhe veprime të tjera, të cilat synojnë asgjësimin e tyre;
- e. duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit dhe mbrojtjen e të dhënave në përmbajtje të çdo sinjalizimi;
- f. duke ruajtur sekretin shtetëror në përmbajtje të një sinjalizimi, në zbatim të ligjit;
- g. duke zbatuar mekanizma të efektshëm dhe të përshtatshëm, për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave legjitimë të sinjalizuesit;
- h. duke përfunduar procedurën e hetimit administrativ të sinjalizimit në mënyrë të shpejtë dhe të besueshme.

KREU II PROCEDURAT E VEPRIMIT

NENI 4 SINJALIZIMI I DREJTPËRDREJTË PRANË ILDKPKI

Inspektorati i Përgjithshëm heton si mekanizëm i jashtëm i sinjalizimit, sinjalizimet e kryera për veprime të kundërligjshme në sektorin publik, sektorin privat apo shkelje të mundshme të kuadrit ligjor, duke përfshirë rastet kur:

- a. sinjalizimi është kryer drejtpërdrejt pranë Inspektoratit të Përgjithshëm;
- b. sinjalizimi është kryer fillimisht pranë Njesisë Përgjegjëse dhe sinjalizuesi vlerëson se shkelja nuk mund të trajtohet në mënyrë efektive brenda autoritetit publik ose subjektit privat;
- c. ekziston rrezik për veprime hakmarrëse ndaj sinjalizuesit, ose personave të lidhur me të;
- ç. sinjalizuesi ka paraqitur fillimisht sinjalizimin pranë Njesisë Përgjegjëse dhe nuk është informuar për ecurinë ose trajtimin e sinjalizimit;
- d. Njësia Përgjegjëse nuk fillon hetimin administrativ të sinjalizimit ose Njësia Përgjegjëse e përfundon hetimin në kundërshtim me dispozitat ligjore;
- dh. ekziston dyshimi i arsyeshëm se pritësi i sinjalizimit në Njësinë Përgjegjëse ose persona të lidhur me të janë të përfshirë ose kanë një interes të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, pasuror ose personal, në veprimin e kundërligjshëm. Sipas rastit, person i lidhur ka të njëjtin kuptim me përcaktimet e bëra në ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike;
- e. ka arsye të tjera të bazuara për të dyshuar në integritetin dhe paanshmërinë e Njesisë Përgjegjëse në shqyrtimin e sinjalizimit;
- ë. prova/t e sinjalizuesit, në lidhje me veprimet e kundërligjshme apo shkeljen e mundshme të kuadrit ligjor, mund të fshihen ose të shkatërrohen nga autoriteti publik ose subjekti privat.

NENI 5 SINJALIZIMI I PËRCJELLË NGA NJË AUTORITET TJETËR

1. Inspektorati i Përgjithshëm regjistron dhe heton si mekanizëm i jashtëm sinjalizimin e përcjellë nga autoritete të tjera, të cilat nuk kanë kompetencë për shqyrtimin e këtij të fundit në kuptim të ligjit.
2. Procedura e hetimit të sinjalizimit të regjistruar sipas pikës 1 të këtij neni, zbatohet në të njëjtën mënyrë, si procedura e sinjalizimit të paraqitur drejtpërdrejt pranë Inspektoratit të Përgjithshëm.

NENI 6 KRYERJA E VEPRIMEVE PROCEDURALE

1. Veprimet procedurale të Inspektoratit të Përgjithshëm kryhen në përputhje me Ligjin nr. 96/2025 dhe në rast të mungesës së parashikimeve nga ky ligj, sipas Kodit të

Procedurave Administrative.

2. Njoftimet për veprimet procedurale, për të cilat Inspektorati i Përgjithshëm cakton afate, duhet të përmbajnë paralajmërimin e shprehur mbi pasojat e mosrespektimit të afatit.

NENI 7

FORMA DHE PËRMBAJTJA E SINJALIZIMIT

1. Sinjalizimi bëhet me çdo mjet komunikimi, në formë të shkruar ose deklarohet verbalisht para punonjësit të caktuar të Inspektoratit të Përgjithshëm dhe dokumentohet me shkrim prej këtij të fundit.
2. Nëse sinjalizimi verbal kryhet nëpërmjet një linje telefonike ose një sistemi tjetër të mesazheve zanore, sinjalizuesi informohet paraprakisht nëse biseda do të regjistrohet.
3. Punonjësi i caktuar nga Inspektorati i Përgjithshëm dokumenton sinjalizimin verbal në një procesverbal, ose kryen një transkriptim të sinjalizimit, kur ky i fundit kryhet në linjë telefonike ose me një sistem tjetër të mesazheve zanore. Sinjalizuesi ka të drejtë të verifikojë, të korrigjojë dhe të konfirmojë përmbajtjen e procesverbalit apo transkriptimit, duke e nënshkruar atë. Në pamundësi për ta nënshkruar transkriptimin, sinjalizuesi mund të konfirmojë përmbajtjen edhe me anë të një komunikimi drejtuar Inspektoratit të Përgjithshëm.
4. Sinjalizimi përmban të paktën:
 - a. të dhënat e identitetit dhe kontaktet e sinjalizuesit, me përjashtim të rasteve kur sinjalizimi është kryer në mënyrë anonime;
 - b. organin ose personin e përfshirë ndaj të cilit kryhet sinjalizimi;
 - c. përshkrimin e fakteve e të rrethanave të njohura nga sinjalizuesi për veprime të kundërligjshme apo shkelje të kuadrit ligjor, shoqëruar me provat përkatëse, për aq sa është e mundur;
 - ç. referimin, për aq sa është e mundur, të parashikimeve të legjislacionit, për të cilat parashtrohet shkelja apo veprimi i kundërligjshëm;
5. Në rastet kur sinjalizimi nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së mësipërme sinjalizuesit i kërkohet me shkrim, të korrigjojë këto të meta brenda 7 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për korrigjim.

NENI 8

SINJALIZIMI ANONIM

1. Sinjalizimet anonime trajtohen nga Inspektorati i Përgjithshëm në të njëjtën mënyrë, si çdo sinjalizim tjetër, pa vendosur kushte shtesë për marrjen, shqyrtimin dhe verifikimin e tyre.
2. Në rast se sinjalizuesi nuk jep pëlqimin e tij të shprehur për identifikim, sinjalizimi trajtohet si sinjalizim anonim.
3. Identiteti i sinjalizuesit, në rastet kur identifikohet, mund të bëhet i njohur vetëm me pëlqimin e tij të shprehur ose me kërkesë të organeve procedurale kompetente, në përputhje me ligjin.

NENI 9

MOSFILLIMI I HETIMIT ADMINISTRATIV

1. Inspektorati i Përgjithshëm ka të drejtë të mos fillojë hetimin administrativ nëse;
 - a. sinjalizimi, me përjashtim të rasteve të sinjalizimit anonim, nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së kërkuar dhe sinjalizuesi nuk korrigjon këto të meta brenda 7 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për korrigjim;
 - b. sinjalizimi përmban fakte dhe rrethana që nuk përfshihen në fushën e zbatimit të Ligjit nr. 96/2025;
 - c. nga përmbajtja e sinjalizimit, si dhe nga verifikimi paraprak, del haptazi se nuk ka elementë të kundërvajtjes administrative ose të veprës penale.
 - ç. sinjalizimi është i përsëritur dhe nuk përmban informacione të reja, përveç rasteve kur paraqiten rrethana të reja ose prova të rëndësishme, që justifikojnë rihapjen e çështjes.
2. Mosfillimi i hetimit administrativ bëhet me vendim të arsyetuar të Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Përgjithshëm.
3. Vendimi i arsyetuar për mosfillimin e sinjalizimit, i përcillet sinjalizuesit pa qenë e nevojshme paraqitja e një kërkesë të veçantë nga ana e këtij të fundit.

KREU III

HETIMI ADMINISTRATIV

NENI 10

REGJISTRIMI I SINJALIZIMIT

1. Sinjalizimi regjistrohet në një regjistër të posaçëm protokolli dhe elektronik, për regjistrimin e sinjalizimeve.
2. Inspektorati i Përgjithshëm nuk mund të refuzojë për asnjë shkak regjistrimin e sinjalizimit.

NENI 11

VERIFIKIMI PARAPRAK

1. Inspektorati i Përgjithshëm kryen verifikim paraprak të sinjalizimit të regjistruar për të verifikuar nëse nga përmbajtja e tij ekzistojnë shkaqe të arsyeshme se informacioni i sinjalizuar përmban elemente të një kundërvajtjeje administrative ose të një veprë penale.
2. Inspektorati i Përgjithshëm, sipas rastit, në kuadër të verifikimi paraprak, vlerëson nevojën për marrjen e masave të përkohshme për mbrojtjen e sinjalizuesit, sipas Ligjit nr.96/2025, nëse krijohet bindja se ai mund të jetë objekt i veprimeve hakmarrëse.

NENI 12

TRAJTIMI ME PËRPARËSI I SINJALIZIMIT

1. Inspektorati i Përgjithshëm trajton sinjalizimet duke marrë për bazë radhën sipas

- parimit të kohës së regjistrimit të sinjalizimit.
2. Në rastet kur ka për trajtim një numër të lartë sinjalizimesh, me vendim të Inspektorit të Përgjithshëm, i jepet përparësi sinjalizimeve që lidhen me çështje me interes të lartë publik, që përfshijnë, por pa u kufizuar, rastet:
 - a. që kanë të bëjnë me rreziqe aktuale apo që ndikojnë në shëndetin publik, sigurinë ose të drejtat dhe liritë themelore;
 - b. që përfshijnë funksionarë të lartë në funksione publike;
 - c. që lidhen me interesa financiare të shtetit ose të BE-së;
 - ç. për të cilat kanalet e brendshme të raportimit nuk kanë funksionuar ose janë penguar.

NENI 13

KËSHILLIMI PËRPARA RAPORTIMIT TË SINJALIZIMIT

1. Në rast se sinjalizuesi kërkon këshillim përpara regjistrimit të sinjalizimit sipas kësaj rregulloreje, punonjësit e Inspektoratit të Përgjithshëm japin informacion të përgjithshëm mbi të drejtat që gëzon sinjalizuesi sipas nenit 6 të Ligjit nr.96/2025 dhe procesin në tërësi. Punonjësit që angazhohen në dhënien e këshillimit, nuk mund të ushtrojnë detyrën e punonjësit të autorizuar për trajtimin e sinjalizimit.
2. Veprimtaria këshilluese nuk konsiderohet raportim i sinjalizimit në kuptim të Ligjit nr.96/2025 dhe të kësaj rregulloreje dhe nuk regjistrohet në regjistrin e sinjalizimit.

NENI 14

PROCEDURA E HETIMIT ADMINISTRATIV

1. Inspektorati i Përgjithshëm heton administrativisht sinjalizimin, në përputhje me procedurën e përcaktuar në Ligjin nr. 96/2025. Për atë që nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj, Njësia apo Inspektorati i Përgjithshëm zbaton dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.
2. Inspektorati i Përgjithshëm ka të drejtë të kërkojë informacione dhe dokumente, të urdhërojë inspektime ose analiza, të mbledhë deklarata ose të pyesë persona në dijeni ose rrethanat e çështjes ose të konsultohet me ekspertë të fushave të ndryshme.
3. Në hetimin administrativ merr pjesë sinjalizuesi dhe çdo person tjetër i tretë, kur dyshohet se posedon dokumente ose ka dijeni për rrethanat e sinjalizuara, përfshirë edhe të sinjalizuarin, nëse vlerësohet e nevojshme nga Inspektorati i Përgjithshëm.
4. Çdo pale pjesëmarrëse në hetimin administrativ i garantohet një proces i rregullt, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative, si dhe:
 - a. mund të japë deklarata me shkrim, argumente ose opinione;
 - b. mund të konsultohet me dosjen e hetimit, me përjashtim të të dhënave të sinjalizuesit dhe të çdo informacioni që mund të çojë në identifikimin e tij, të cilat paraqiten në mënyrë të anonimizuar;
 - c. ka të drejtë të dëgjohet në lidhje me pretendimet e tij.
5. Inspektorati i Përgjithshëm njofton sinjalizuesin për çdo masë të marrë në përgjigje të sinjalizimit jo më vonë se 30 ditë nga momenti i kryerjes së veprimit. Pavarësisht nga afati i njoftimit të parashikuar në këtë pikë, Inspektorati i Përgjithshëm është e

detyruar t'i përgjigjet brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës për informacion, të paraqitur me shkrim nga sinjalizuesi, në çdo kohë, në lidhje me çështjen e sinjalizuar prej tij.

6. Inspektorati i Përgjithshëm merr masa të menjëhershme, të çastit dhe për aq sa është e mundur, për të parandaluar ose penguar vazhdimin e pasojave të dëmshme nga veprimi i kundërligjshëm i sinjalizuar në sektorin publik apo sektorin privat.
7. Nëse në përfundim të hetimit administrativ nga Inspektorati i Përgjithshëm rezulton se sinjalizimi ka elementë të një shkelje administrative, sipas ligjit, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Përgjithshëm, sipas rastit, vë në dijeni organin kompetent.

NENI 15

PROVAT NË HETIMIN ADMINISTRATIV

1. Inspektorati i Përgjithshëm dokumenton çdo veprim që kryen gjatë hetimit administrativ. Dokumentet e nevojshme për hetimin administrativ merren apo pranohen pa pagesë. Çdo shkelje e detyrimit të zyrtarëve apo të subjekteve private për dhënie dokumentacioni shkresor apo dokumenti tjetër provues, përbën shkak për fillimin e procedimit ligjor në varësi të shkeljes së konstatuar.
2. Punonjësit e Inspektoratit të Përgjithshëm kanë të drejtë të këqyrin sende, vende apo dokumentacion me qëllim fiksimin dhe dokumentimin e veprimeve apo të pasojave të veprimtarisë të dyshuara si të kundërligjshme. Dokumentimi mund të bëhet me procesverbal, me mjete të tjera fotografike e filmike apo në çdo mënyrë tjetër të ligjshme.
3. Në raste të veçanta, kur punonjësit e Inspektoratit të Përgjithshëm vlerësojnë se ekzistojnë rrethanat për manipulimin apo asgjësimin e dokumenteve shkresore, punonjësit bllokojnë dokumentacionin apo mjetet e tjera provuese. Zyrtarët përgjegjës apo personat e tjerë janë të detyruar të mos kryejnë asnjë veprim mbi këto dokumente, gjatë gjithë kohës që ato janë të bllokuara. Në çdo rast mbahet një procesverbal, që nënshkruhet nga inspektorët dhe zyrtarët përgjegjës apo personat e tjerë. Zhbllokimi i dokumentacionit bëhet me urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Përgjithshëm.
4. Gjatë ushtrimit të detyrës punonjësit e Inspektoratit të Përgjithshëm zbatojnë, për aq sa mund të jetë e përshtatshme, të gjitha mjetet dhe mënyrat provuese të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.
5. Në fund të kontrollit mbahet akt-kontrolli, i cili nënshkruhet nga punonjësit e Inspektoratit të Përgjithshëm dhe zyrtarët e organit shtetëror apo personat drejtues në subjekte private. Në rast se këta të fundit nuk janë dakord me përmbajtjen e aktit kanë të drejtë të bëjnë vërejtje dhe të paraqesin kundërshtime. Kopje të argumenteve dhe të dokumenteve kundërshtuese i bashkëlidhen aktit.

NENI 16

PJESËMARRJA E SINJALIZUESIT GJATË HETIMIT ADMINISTRATIV

1. Gjatë hetimit administrativ të sinjalizimit, sinjalizuesi mund të thirret për tu paraqitur nga Inspektorati i Përgjithshëm apo të paraqitet me kërkesë të tij për të dhënë

shpjegime apo akte provuese shitesë që janë të nevojshme për hetimin.

2. Kur sinjalizimi është anonim, paraqitja e shpjegimeve apo akteve provuese kryhet nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik që përmbushin garancitë për ruajtjen e identitetit të sinjalizuesit.

NENI 17

PJESËMARRJA E TË SINJALIZUARIT GJATË HETIMIT ADMINISTRATIV

1. Personi i sinjalizuar apo personat e përfshirë, marrin pjesë në procesin e hetimit administrativ kur pjesëmarrja e tyre çmohet e nevojshme nga Inspektorati i Përgjithshëm.
2. Në rastet kur Inspektorati i Përgjithshëm vlerëson se thirrja e të sinjalizuarit apo personave të përfshirë mund të përbëjë rrezik për fshehjen, prishjen apo asgjësimin e provave, njoftimi mund të kryhet pas sigurimit të provave sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje.

NENI 18

PËRFUNDIMI I HETIMIT ADMINISTRATIV

1. Inspektorati i Përgjithshëm përfundon hetimin administrativ nëse:
 - a. gjatë hetimit rezulton se sinjalizimi është i bazuar, duke referuar çështjen menjëherë në autoritetin kompetent kur përmban elemente të kundërvajtjes administrative ose në organet e prokurorisë, apo Policisë së Shtetit kur dyshohet për vepër penale.
 - b. sinjalizimi rezulton i pabazuar në fakte dhe të dhëna;
 - c. sinjalizuesi ka paraqitur me dashje informacion të rremë ose të pasaktë.
2. Referimi i çështjes pranë organit kompetent në zbatim të pikës 1, gërma a, të këtij neni, bëhet me të dhëna të anonimizuara ose të depersonalizuara, në lidhje me identitetin e sinjalizuesit.
3. Kundër vendimit të Inspektoratit të Përgjithshëm për përfundimin e hetimit mund të bëhet ankim, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.
4. Në dosjen e sinjalizimit shënohet vendimi për përfundimin e hetimit administrativ nga Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Përgjithshëm, i arsyetuar për të gjitha shkaqet që kanë çuar në vendimmarrjen përkatëse, si dhe masat e marra në lidhje me sinjalizimin.
5. Vendimi i arsyetuar për përfundimin e hetimit, i përcillet sinjalizuesit pa qenë e nevojshme paraqitja e një kërkesë të veçantë nga ana e tij.

NENI 19

AFATI PËR VENDIMMARRJEN

1. Procedura e hetimit administrativ të sinjalizimit nga Inspektorati i Përgjithshëm përfundon sa më shpejt të jetë e mundur, por, në çdo rast, jo më vonë se 90 ditë nga data e fillimit të hetimit, përveçse kur nga rrethanat kërkohet një afat më i gjatë.
2. Shtyrja e afatit për hetimin administrativ bëhet me vendim të arsyetuar të Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Përgjithshëm, duke përcaktuar edhe afatin e ri

kohor të shtyrjes në përputhje me vështirësinë dhe kompleksitetin e çështjes.

KREU IV

RUAJTJA E KONFIDENCIALITETIT DHE TË DHËNAVE PERSONALE

NENI 20

KONFIDENCIALITETI

1. Gjatë procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit identiteti i sinjalizuesit u bëhet i ditur personave të tretë vetëm me pëlqimin e tij me shkrim.
2. Identiteti i personit të përfshirë, si dhe çdo informacion tjetër që lidhet me të, ruhet dhe mbrohet në kushte konfidencialiteti nga Inspektorati i Përgjithshëm.
3. Inspektorati i Përgjithshëm duhet të ruajë në çdo kohë në mënyrë konfidenciale informacionin e lidhur me sinjalizimin, duke mos e përhapur ose transmetuar tek persona të tretë, si dhe të mos e përdorë për qëllime të tjera, përveç rasteve kur është e nevojshme për zbatimin e Ligjit nr. 96/2025.
4. Zbulimi i identitetit të sinjalizuesit dhe i të dhënave të përpunuara, sipas pikës 1 të këtij neni, mund të kryhet edhe pa pëlqimin e tij, vetëm në rastet kur është i domosdoshëm në mënyrë të arsyetuar e proporcionale për nevoja të hetimit penal ose të procesit gjyqësor.
5. Inspektorati i Përgjithshëm njofton me shkrim sinjalizuesin, mbi arsyet e justifikuara për zbulimin e të dhënave konfidenciale, si dhe masat e marra për të kufizuar sa më shumë rrezikun e ekspozimit të panevojshëm, përveç rasteve kur një informim i tillë do të rrezikonte hetimin ose procedimin gjyqësor.

NENI 21

STANDARDET E KONFIDENCIALITETIT NË USHTRIMIN E TË DREJTËS PËR NJOHJEN ME DOSJEN

1. Çdo e dhënë e dosjes hetimore që mund të çojë në identifikimin e sinjalizuesit, duke përfshirë të dhënat e sinjalizuesit paraqiten në mënyrë të anonimizuar për palët e treta.
2. Vendimmarrjet që përmbajnë të dhëna për procedurën hetimore dhe gjetjet mbi sinjalizimin vihen në dispozicion të palëve të treta në mënyrë të anonimizuar.

NENI 22

MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

1. Të dhënat personale të individëve të përfshirë në hetimin administrativ përpunohen vetëm për qëllim të Ligjit nr. 96/2025. Në çdo rast, përpunimi i të dhënave personale kryhet sipas parimeve dhe procedurave të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Në rast se të dhënat personale, që nuk konsiderohen të nevojshme për hetimin mblidhen rastësisht, ato fshihen menjëherë, dhe nuk përfshihen në hetimin administrativ.
3. Në rastet kur, gjatë zbatimit të Ligjit nr. 96/2025 dhe kësaj Rregulloreje, konstatohen shkelje të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, çështja i referohet

Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

NENI 23

RUAJTJA E TË DHËNAVE DHE ADMINISTRIMI I DOKUMENTACIONIT

1. Inspektorati i Përgjithshëm siguron gjurmueshmërinë e të dhënave e të informacionit, si dhe ruan dokumentacionin e krijuar në formë shkresore ose elektronike, duke garantuar njëkohësisht konfidencialitetin e mbrojtjen e të dhënave personale të sinjalizuesit dhe të personave të përfshirë.
2. Dokumentacioni origjinal ruhet për një periudhë 5-vjeçare nga data e komunikimit të rezultatit përfundimtar të procedurës së sinjalizimit, përveç rasteve kur procedura ligjore përkatëse ende nuk ka përfunduar.

KREU V

AKTET RREGULLATORE TË NJËSIVE PËRGJEGJËSE

NENI 24

HETIMI ADMINISTRATIV I SINJALIZIMEVE TË BRENDSHME NË ILDKPKI

1. Parashikimet e kësaj rregulloreje në lidhje me hetimin administrativ të sinjalizimeve dhe marrjen e masave për mbrojtjen e konfidencialitetit, zbatohen edhe për Njësine Përgjegjëse të krijuar pranë Inspektoratit të Përgjithshëm, si mekanizëm i brendshëm i sinjalizimit.
2. Në rastin e sinjalizimeve të brendshme pranë Njesisë Përgjegjëse, vendimi për fillimin e hetimit administrativ dhe vendimmarrja për përfundimin apo mosfillimin e hetimit merren nga nëpunësit përgjegjës të kësaj njësie.

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
INSPEKTORATI I PËRGJITHSHËM

RREGULLORE
PËR HETIMIN ADMINISTRATIV TË KËRKESËS SË SINJALIZUESIT PËR
MBROJTJEN NGA VEPRIMET HAKMARRËSE NË INSPEKTORATIN E
PËRGJITHSHËM

Tiranë, Korrik 2026

KREU I RREGULLA TË PËRGJITHSHME

NENI 1 BAZA LIGJORE

Rregullorja për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga veprimet hakmarrëse, bazohet në Ligjin nr. 96/2025 *“Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”*, Kodin e Procedurave Administrative, si dhe në urdhrat, udhëzimet dhe aktet e tjera nënligjore, të miratuara nga Inspektori i Përgjithshëm.

NENI 2 OBJEKTI

Objekti i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i rregullave për procedurën e hetimit administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja, në zbatim të Ligjit nr. 96/2025 *“Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”*.

KREU II E DREJTA PËR MBROJTJE DHE MASAT MBROJTËSE

NENI 3 E DREJTA PËR MBROJTJE

1. Mbrojtja e sinjalizuesit nga çdo formë hakmarrje garantohet përmes mekanizmave të parashikuara në Ligjin nr. 96/2025.
2. Sinjalizuesi gëzon të drejtat e mëposhtme:
 - a. mbrojtje nga të gjitha format e hakmarrjes;
 - b. mbrojtje të identitetit dhe ruajtje të konfidencialitetit gjatë procesit të sinjalizimit, përfshirë edhe rastet e sinjalizimit anonim;
 - c. ruajtje të konfidencialitetit të burimit të informacionit të sinjalizuar;
 - ç. ndihmë juridike falas, në përputhje me Ligjin nr.11/2017, *“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”*;
 - d. kompensim të dëmit të shkaktuar, si rezultat i veprimeve hakmarrëse.
3. Ndihmësit, personat e lidhur me sinjalizuesin, si dhe personat juridikë që sinjalizuesi zotëron, për të cilët punon ose me të cilët është i lidhur në një kontekst të lidhur me punën, gëzojnë të drejtën e mbrojtjes sipas pikës 2 të këtij neni.
4. Të drejtat e sinjalizuesit garantohen në kuptim të Ligjit nr. 96/2025:
 - a. gjatë kohëzgjatjes së procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit;
 - b. pas përfundimit të procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit, për të siguruar vijimin normal të ushtrimit të detyrës në autoritetin publik ose në subjektin privat;

- c. pas përfundimit të marrëdhënies së punës së sinjalizuesit në autoritetin publik ose në subjektin privat, kur sinjalizuesi, mbi bazën e rrethanave të arsyeshme, ka paraqitur kërkesë për mbrojtje pranë Inspektoratit të Përgjithshëm.
5. Sinjalizuesi nuk mban përgjegjësi ligjore për marrjen ose aksesimin e informacionit që raportohet apo publikohet, për sa kohë që ky veprim nuk përbën një vepër penale të veçantë. Në rastet kur marrja ose aksesimi përbën një vepër penale të veçantë, përgjegjësia penale vlerësohet dhe trajtohet sipas legjislacionit në fuqi.
 6. Çdo rregull ose marrëveshje private, që synon të përjashtojë ose të kufizojë të drejtat e sinjalizuesit, të parashikuara në këtë ligj, është e pavlefshme. Të drejtat e sinjalizuesit kanë epërsi ndaj çdo marrëveshjeje për konfidencialitetin.
 7. Sinjalizuesi, ndihmësi, personat e lidhur me sinjalizuesin, si dhe personat juridikë që sinjalizuesi i zotëron, për të cilët punon ose me të cilët është i lidhur në një kontekst të lidhur me punën, kanë akses në mjete juridike mbrojtëse kundër veprimeve hakmarrëse, përfshirë masat e përkohshme, deri në përfundimin e procedurave përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
 8. Sinjalizuesi, ndihmësi ose personat e lidhur me ta gëzojnë mbrojtje nga nisja e procedimeve penale, civile ose administrative për shkak të sinjalizimit të kryer ose bërjes publike të informacionit në përputhje me Ligjin nr. 96/2025 *“Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”*.
 9. Sinjalizuesi informohet nga Inspektorati i Përgjithshëm për të drejtat dhe mbrojtjen e ofruar sipas Ligjit nr. 96/2025 *“Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”*.

NENI 4

KUSHTET PËR MBROJTJEN E SINJALIZUESIT

1. Sinjalizuesi gëzon të drejtën për mbrojtje, pavarësisht mekanizmit të përdorur, kur plotësohen njëkohësisht këto kushte:
 - a. ka pasur shkaqe të arsyeshme për të besuar se informacioni i sinjalizuar ose i bërë publik për një shkelje të mundshme të kuadrit ligjor ishte i vërtetë në momentin e sinjalizimit ose të publikimit, pavarësisht nëse më pas rezulton ndryshe;
 - b. ka pasur shkaqe të arsyeshme për të besuar se informacioni i sinjalizuar përfshihet në fushën e zbatimit të këtij ligji;
 - c. sinjalizimi është kryer në përputhje me dispozitat e ligjit nëpërmjet një mekanizmi të brendshëm, të jashtëm ose nëpërmjet publikimit të informacionit.
2. Në rastet kur sinjalizimi është bërë në mënyrë anonime dhe përmbush kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, sinjalizuesi gëzon të drejtën për mbrojtje edhe nëse identiteti i tij është zbuluar më vonë pa pëlqimin e tij të shprehur dhe është bërë objekt i veprimeve hakmarrëse.
3. Sinjalizuesi, që sinjalizon publikisht një shkelje të mundshme të kuadrit ligjor në fushat e përcaktuara sipas këtij ligji, gëzon të drejtën për mbrojtje në të njëjtat kushte.
4. Personat që sinjalizojnë shkelje që hyjnë në fushën e këtij ligji, gëzojnë mbrojtjen e parashikuar

në këtë ligj në të njëjtat kushte si personat që sinjalizojnë në mënyrë të jashtme.

NENI 5

MASAT PËR MBROJTJEN E PERSONAVE TË PËRFSHIRË

1. Personat e përfshirë në sinjalizim, përfshirë ata ndaj të cilëve është bërë raportimi ose publikimi i shkeljes, gëzojnë të drejtën për një mjet juridik efektiv dhe për një proces të rregullt ligjor. Këto të drejta përfshijnë, ndër të tjera, parimin e prezumimit të pafajësisë, të drejtën për mbrojtje, të drejtën për t'u dëgjuar dhe të drejtën për t'u njohur me dokumentacionin përkatës.
2. Inspektorati i Përgjithshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi, garanton mbrojtjen e identitetit të personave të përfshirë, për sa kohë që hetimet e nisura, si rezultat i sinjalizimit ose publikimit janë në proces.
3. Dispozitat e Ligjit nr.96/2025, që rregullojnë konfidencialitetin dhe mbrojtjen e identitetit të sinjalizuesit, zbatohen në mënyrë të njëjtë edhe për personat e përfshirë deri në përfundimin e procedurave administrative përkatëse.

NENI 6

MBROJTJA KUNDËR VEPRIMEVE HAKMARRËSE

1. Sinjalizuesi, i cili sinjalizon, sipas Ligjit nr. 96/2025, veprime të kundërligjshme ose shkelje të mundshme të kuadrit ligjor në Inspektoratin e Përgjithshëm mbrohet ndaj çdo veprimi hakmarrës të marrë ndaj tij nga autoriteti publik apo subjekti privat, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:
 - a. shkarkimin nga puna;
 - b. pezullimin nga puna, ose të një, apo më shumë detyrave;
 - c. transferimin brenda ose jashtë organizatës, ose ndryshimin e orarit të punës;
 - ç. uljen në detyrë;
 - d. uljen e pagës dhe/ose të shpërblimeve financiare;
 - dh. humbjen e statusit profesional ose e privilegjeve të lidhura me pozicionin;
 - e. mohimin e mundësisë për ngritje në detyrë;
 - ë. heqjen e së drejtës për të marrë pjesë në trajnime;
 - f. vlerësimet negative në marrëdhënien e punës;
 - g. intimidimin, ngacmimin, presionin psikologjik apo përjashtimin nga ambienti i punës;
 - gj. diskriminimin ose trajtimin e padrejtë;
 - h. mosrinovimin e kontratës së përkohshme në një kontratë të përhershme, kur punonjësi kishte pritshmëri të ligjshme për punësim të përhershëm;
 - i. përfundimin ose mosrinovimin e kontratës së përkohshme;
 - j. dëmtimin e reputacionit, kryesisht në mediat sociale, ose humbjen e të ardhurave apo e mundësive të biznesit;
 - k. përfshirjen në “listë të zezë” nëpërmjet marrëveshjeve formale, ose informale, që pengojnë punësimin në sektorin përkatës në të ardhmen;

- l. përfundimin ose anulimin e parakohshëm të kontratës për mallra ose shërbime;
 - ll. anulimin e licencës, ose të lejes së ushtrimit të aktivitetit;
 - m. referimin e pa justifikuar për ekzaminim psikiatrik ose mjekësor;
 - n. kërcënimin, ose përpjekjen për të ndërmarrë secilin nga veprimet e mësipërme;
 - nj. izolimin profesional, përjashtimin nga proceset vendimmarrëse apo marginalizimin e heshtur në ambientin e punës.
2. Sinjalizuesi paraqet kërkesë për mbrojtje pranë Inspektorati i Përgjithshëm, nëse vlerëson se është bërë objekt i veprimeve hakmarrëse për shkak të sinjalizimit.
 3. Nëse sinjalizuesi kërkon të vendoset në një strukturë tjetër të autoritetit publik ose subjektit privat, për shkak të krijimit të një mjedisi pune armiqësor si pasojë e sinjalizimit, autoriteti publik ose subjekti privat merr masat e nevojshme për realizimin e kësaj zhvendosjeje.
 4. Në rast të mos marrjes së masave brenda një afati të arsyeshëm, Inspektorati i Përgjithshëm, me kërkesë të sinjalizuesit, i drejtohet Njësine më varësi për të urdhëruar marrjen e masave përkatëse.
 5. Nëse Njësia nuk zbaton masat e urdhëruara, brenda një afati prej 10 ditësh kalendarike nga data e marrjes së kërkesës, sinjalizuesi ose çdo person i interesuar ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës.

KREU III

HETIMI ADMINISTRATIV

NENI 7

KRYERJA E VEPRIMEVE PROCEDURALE

1. Veprimet procedurale të Inspektorati i Përgjithshëm kryhen në përputhje me Ligjin nr. 96/2025 dhe në rast të mungesës së parashikimeve nga ky ligj, sipas Kodit të Procedurave Administrative.
2. Njoftimet për veprimet procedurale, për të cilat Inspektorati i Përgjithshëm cakton afate, duhet të përmbajnë paralajmërimin e shprehur mbi pasojat e mosrespektimit të afatit.

NENI 8

VERIFIKIMI PARAPRAK

1. Inspektorati i Përgjithshëm kryen verifikimin paraprak të kërkesës për mbrojtje nga veprimet hakmarrëse për të verifikuar nëse:
 - a) sinjalizuesi plotëson kushtet e parashikuara në nenin 7 të Ligjit nr. 96/2025 për të gëzuar të drejtën për mbrojtje sipas ligjit;
 - b) ekziston lidhje e arsyeshme midis sinjalizimit të kryer për shkelje të mundshme të kuadrit ligjor dhe veprimit hakmarrës të ndërmarrë nga autoriteti publik ose nga subjekti privat kundrejt tij.
2. Në rast se nuk plotësohen kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, Inspektorati i Përgjithshëm vendos rrëzimin e kërkesës për mbrojtje nga veprimet hakmarrëse.

3. Në rast se plotësohen kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, gjatë verifikimit paraprak por jo më vonë se 7 ditë nga paraqitja e kërkesës, Inspektorati i Përgjithshëm shqyrton nevojën për marrjen e një vendimi të ndërmjetëm të arsyetuar për pezullimin e çdo veprimi hakmarrës ndaj sinjalizuesit deri në përfundimin e hetimit.
4. Inspektorati i Përgjithshëm njofton sinjalizuesin për rezultatet e verifikimit paraprak brenda 7 ditëve nga regjistrimi i kërkesës.

NENI 9

PROCEDURA E HETIMIT TË KËRKESËS PËR MBROJTJE

1. Procedura e hetimit të kërkesës për mbrojtje nga veprimet hakmarrëse fillon me dorëzimin e kërkesës së sinjalizuesit pranë Inspektorati i Përgjithshëm.
2. Inspektorati i Përgjithshëm regjistron dhe heton kërkesën për të vlerësuar nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për të besuar se një veprim hakmarrës ka ndodhur, është duke ndodhur ose pritet të ndodhë.
3. Brenda 5 ditëve nga marrja e kërkesës, Inspektorati i Përgjithshëm njofton me shkrim sinjalizuesin për regjistrimin e saj dhe i bën me dije emrin e punonjësit përgjegjës për ndjekjen e çështjes.
4. Inspektorati i Përgjithshëm merr masa të menjëhershme me vendim të ndërmjetëm, jo më vonë se 7 ditë nga paraqitja e kërkesës, kur çmon se ekziston rreziku i një veprimi hakmarrës.
5. Inspektorati i Përgjithshëm njofton me shkrim sinjalizuesin, brenda 7 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për mbrojtje, për statusin e hetimit administrativ dhe për çdo veprim procedural të ndërmarrë.
6. Çdo pale pjesëmarrëse në hetimin administrativ i garantohet një proces i rregullt, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative, si dhe:
 - a. mund të japë deklarata me shkrim, argumente ose opinione;
 - b. mund të konsultohet me dosjen e hetimit, me përjashtim të të dhënave të sinjalizuesit dhe të çdo informacioni që mund të çojë në identifikimin e tij, të cilat paraqiten në mënyrë të anonimizuar;
 - c. ka të drejtë të dëgjohet në lidhje me pretendimet e tij.

NENI 10

VENDIMI I NDËRMJETËM PËR PEZULLIMIN E ÇDO VEPRIMI HAKMARRËS NDAJ SINJALIZUESIT

1. Inspektorati i Përgjithshëm merr masa të menjëhershme, jo më vonë se 7 ditë nga paraqitja e kërkesës dhe, kur çmon se ekziston rreziku i një veprimi hakmarrës, vendos me një akt të ndërmjetëm të arsyetuar pezullimin e çdo veprimi hakmarrës ndaj sinjalizuesit deri në përfundimin e hetimit.
2. Vendimi i ndërmjetëm për pezullimin e veprimeve hakmarrëse në kuptim të Ligjit nr. 96/2025 ndaj sinjalizuesit përfshin:

- a. ndalimin për njësinë në varësi për të ndërmarrë veprime të reja hakmarrëse ndaj sinjalizuesit deri në përfundimin e hetimit administrativ;
 - b. pezullimin e çdo veprimi hakmarrës të ndërmarrë ndaj sinjalizuesit, deri në përfundimin e hetimit.
3. Vendimi i përkohshëm përmban llojin e masës së urdhëruar, subjektin ndaj të cilit drejtohet dhe kohëzgjatjen e saj.
 4. Vendimi i ndërmjetëm i njoftohet vetëm sinjalizuesit, përveç rasteve kur zbatimi i tij kërkon ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të institucionit apo të subjektit privat për ndalimin e një veprimi të identifikuar.

NENI 11

HETIMI ADMINISTRATIV DHE BARRA E PROVËS

1. Inspektorati i Përgjithshëm heton administrativisht pretendimet për veprime hakmarrëse për të përcaktuar nëse ka shkaqe të arsyeshme për të besuar që ka ndodhur, është duke ndodhur, ose pritet të ndodhë një akt hakmarrjeje.
2. Inspektorati i Përgjithshëm, në hetimin administrativ, i kërkon informacion me shkrim Njesisë në varësi të provojë që masat e marra në dëm të sinjalizuesit janë bazuar në shkaqe të ndryshme dhe që nuk lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me sinjalizimin. Njësia në varësi ka barrën e provës në këtë proces dhe i përgjigjet Inspektorati i Përgjithshëm me shkrim brenda 10 ditësh nga data e Kërkesës.

NENI 12

BASHKËPUNIMI

1. Njësia në varësi dhe sinjalizuesi bashkëpunojnë me Inspektorati i Përgjithshëm në përcaktimin e fakteve dhe rrethanave të nevojshme për zgjidhjen e çështjes së veprimeve hakmarrëse ndaj sinjalizuesit.
2. Njësia është i detyruar të paraqesë informacione, prova, dokumente, deklarata apo për t'u paraqitur personalisht përpara Inspektorati i Përgjithshëm.

NENI 13

MJETET E KËRKIMIT TË PROVËS

1. Gjatë hetimit administrativ Inspektorati i Përgjithshëm me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen mund:
 - a. të mbledhë deklarata nga palët, dëshmitarët dhe ekspertët;
 - b. të marrë dokumente dhe prova të tjera të dokumentuara nëpërmjet mjeteve fotografike, të regjistrimit apo në çdo mënyrë tjetër të ligjshme;
 - c. të vizitojë vende të caktuara;
 - d. të urdhërojë inspektime ose analiza.

2. Kur një provë, nga e cila varet zgjidhja e çështjes së aktit të hakmarrjes ose që ndikon në sqarimin e saj, ka rrezik të zhduket ose të vështirësohet ose bëhet e pamundur marrja e saj, Inspektorati i Përgjithshëm kryesisht apo me kërkesën e sinjalizuesit, mund të vendosë marrjen më parë të kësaj prove (sigurimi i provës).
3. Inspektorati i Përgjithshëm mund të vendosë sigurimin e provës edhe përpara fillimit të procedurës administrative. Sigurimi i provës mund të bëhet edhe në çdo fazë të procedurës administrative. Përgjegjësia për sigurimin e provave bie mbi Inspektoratin e Përgjithshëm

NENI 14

NDËRVEPRIMI ME SINJALIZUESIN

1. Inspektorati i Përgjithshëm njofton me shkrim sinjalizuesin brenda afateve të përcaktuara në nenin 9 të kësaj rregulloreje për veprimet procedurale të kryera.
2. Pavarësisht nga afatet e njoftimit të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, Inspektorati i Përgjithshëm është e detyruar t'i përgjigjet çdo kërkesë për informacion me shkrim, paraqitur në çdo kohë nga sinjalizuesi në lidhje me kërkesën e tij për mbrojtje.

KREU IV

AFATI PËR PROCEDURËN E HETIMIT

NENI 15

MASAT NË PËRFUNDIM TË HETIMIT ADMINISTRATIV

1. Nëse në përfundim të hetimit administrativ rezulton se është kryer një akt hakmarrjeje ndaj sinjalizuesit nga njësitë në varësi, Inspektorati i Përgjithshëm urdhëron njësinë në varësi, sipas legjislacionit në fuqi, të marrë të gjitha masat për riparimin e shkeljes së kryer. Inspektori i Përgjithshëm parashikon në shkresë edhe rekomandimin konkret për llojin e masës që duhet të merret.
2. Nëse organi kompetent nuk merr masat e kërkuara nga Inspektorati i Përgjithshëm, sinjalizuesi ose çdo person i interesuar ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës kompetente.

NENI 16

AFATI I PËRFUNDIMIT TË HETIMIT ADMINISTRATIV

Procedura e hetimit administrativ të kërkesës për mbrojtje nga hakmarrja përfundon sa më shpejt të jetë e mundur, por në çdo rast jo më vonë se 60 ditë nga data e regjistrimit të kërkesës.

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi: K. Selimi

Pranoi: E. Kanani

Miratoi: E. Bushati